



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 26 Prot.

Rrëshen me, 05 .01 . 2026

V E N D I M

Nr. 108 datë 29. 12. 2025

P Ë R

**“MIRATIMIN E DHËNIES ME QERA DHE LIDHJEN E KONTRATËS SË RE TË
QERASË MES BASHKISË MIRDITË DHE ‘REÇI KGM SHPK’”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 54 gërma e), të ligjit Nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar; Nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; VKM Nr. 54 datë 05.02.2024 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të menyrës së dhënies me qera, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; Vendimi i Këshillit të ish-Bashkisë Rrëshen, me Nr. 20, datë 23. 05. 2006 (konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr. 662/9 datë 02.06.2006); Kërkesës nr. 6088 prot, datë 04.12.2025 të Media Plus, për rinovimin e kontratës së qerasë, relacionin nr. 6350 prot, datë 24.12.2025, së bashku me projekt-vendimin e Kryetarit të Bashkisë, shqyrtimin/miratimin në mbledhjen e datës 29.12.2025, të Komisionit Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Strehimit, për t’a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Mirditë, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien me qera të ambienteve të Pallatit të Kulturës Rrëshen, me sipërfaqe totale prej 264 m², për ushtrimin e aktivitetit “Media Elektronike Lokale (TV Lokal Mirdita)”.
2. Qiramarrësi miratohet shoqëria “REÇI KGM” Shpk, me NUIS K68718037N, me afat 10 (dhjetë) vjeçar, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës së re.
3. Vlera e qerasë mujore, kushtet e përdorimit, detyrimet dhe të drejtat e palëve përcaktohen në kontratën e re të qerasë, e cila do të jetë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohet; Kryetari i Bashkisë Mirditë për lidhjen e kontratës përkatëse.

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



ADRESA: SHESH “ABET DUCI” RRËSHEN

KRYETAR

Aleksandër PICAKU



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6350 / Prot

Rrëshen më, 24 . 12 . 2025

P/VENDIM

Nr. 118 , datë 24 . 12 . 2025

PËR

“MIRATIMIN E DHËNIES ME QERA DHE LIDHJEN E KONTRATËS SË RE TË QERASË MES BASHKISË MIRDITË DHE ‘REÇI KGM SHPK’”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 54 gërma e), të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”; Nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; VKM Nr. 54 datë 05.02.2024 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të menyrës së dhënies me qera, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; Vendimi i Këshillit Bashkiak Mirditë Nr. 20 datë 23.05.2006 (konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën Nr. 662/9 datë 02.06.2006); Kërkesës Nr. 6088 Prot., datë 04.12.2025 të Media Plus, për rinovimin e kontratës së qerasë;

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien me qera të ambienteve të Pallatit të Kulturës Rrëshen, me sipërfaqe totale 264 m², për ushtrimin e aktivitetit “Media Elektronike Lokale (TV Lokal Mirdita)”.
2. Qiramarrësi miratohet shoqëria **“REÇI KGM”** sh.p.k, me NUIS K68718037N me afat **10 vjeçar**, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës së re.
3. Vlera e qerasë mujore, kushtet e përdorimit, detyrimet dhe të drejtat e palëve përcaktohen në kontratën e re të qerasë, e cila do të jetë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë për lidhjen e kontratës përkatëse dhe ndjekjen e zbatimit të saj.

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” (të ndryshuar)!

SEKRETARI

Gasper TOPOLLAJ


KRYETARI

Aleksandër PICA KU

Spektori Juridik, Jurist; Ndue PERLALA

KRYETARI

Albert MËLVSHI





**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 6350 Prot

Rrëshen më, 24.12. 2025

RELACION

**PËR PROJEKTVENDIMIN PËR
“MIRATIMIN E DHËNIES ME QERA DHE LIDHJEN E KONTRATËS SË RE TË
QERASË MES BASHKISË MIRDITË DHE ‘REÇI KGM SHPK’”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 54 gërma e), të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”; Nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; VKM Nr. 54 datë 05.02.2024 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të menyrës së dhënies me qera, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; Vendimi i Këshillit Bashkiak Mirditë Nr. 20 datë 23.05.2006 (konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën Nr. 662/9 datë 02.06.2006); Kërkesës Nr. 6088 Prot., datë 04.12.2025 të Media Plus, për rinovimin e kontratës së qerasë;

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Mirditë ka lidhur në vitin 2006 kontratë qiraje me shoqërinë “REÇI KGM” sh.p.k, për dhënien me qera të ambienteve të Pallatit të Kulturës Rrëshen, me qëllim ushtrimin e aktivitetit të medias elektronike lokale.

Me vendimin Nr. 20 datë 23.05.2006 të Këshillit Bashkiak Rrëshen, kjo kontratë është lidhur për 10 (dhjetë) vjet. Kontrata është rilidhur në vitin 2015 me kontratën Nr. 1156 Prot., datë 27.05.2015 po ashtu me një afat 10 (dhjetë) vjeçar.

Afati i kontratës dhe i zgjatjes së saj ka përfunduar dhe nuk ekziston një akt i vlefshëm juridik në fuqi që të justifikojë vijimin e marrëdhënies së qirasë. Në mungesë të një kontrate të re përdorimi i pasurisë publike do të ishte pa titull juridik. Ndaj shikohet nevojë e menjëhershme rilidhja e kontratës së re.

Aktiviteti i medias lokale i shërben interesit publik dhe informimit të komunitetit, ka vijuar në mënyrë të pandërprerë dhe nuk ka cënuar destinacionin e objektit dhe është ushtruar në përputhje me qëllimin fillestar.

Ky projekt-vendim synon formalizimin e marrëdhënies juridike, garantimin e përdorimit të ligjshëm të pasurisë publike, përditësimin e kontratës sipas kuadrit ligjor aktual.

Për sa më sipër, propozohet miratimin i projekt-vendimit bashkëlidhur.

Spektori Juridik, Jurist; Ndue PERLALA

KRYETARI

Albert MELYSHI

